
RECENSIONE

**PETRIKA THËNGJILLI: ALIU MIDIS HISTORISË
DHE LEGJENDËS, Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
Tiranë: 2019, 1010 f.**

Ndonëse është shkruar shumë për Ali Pashë Tepelenën, punimi dëshmon se ka nevojë për shkrime të tjera për ta sqaruar më mirë këtë figurë historike që ai të zërë vendin që meriton në historinë e popullit shqiptar, duke u bazuar në dokumente historike, siç është vepruar në këtë rast. Dokumentet e hulumtuara nga autori në Arkivat e Turqisë dhe nga bashkëpunëtorët e tij, si dhe ato të arkivit personal të Aliut, shfrytëzimi i dokumentacionit rus dhe ai anglez e francez dhe baza bibliografike tepër e gjerë në gjuhë të huaj dhe në shqip, janë dy tiparet që i japin punimit një epërsi me ato ç'ka është shkruar deri tani.

Si rezultat i një pune disavjeçare hulumtuese dhe krahasuese, autori ka arritur në mjaft rezultate, disa prej të cilave po i renditim më poshtë:

Punimi përbëhet nga dy pjesë organike të një të tërë. Pjesa e parë analizon aktivitetin e Aliut në krijimin e Pashallëkut të Janinës deri në shtrirjen maksimale, ballafaqimin me pushtetin qendror dhe fundi tragjik që pësoi në këtë përballje. Pasi jepet një panoramë për çdo çështje e pikëpamje që ekzistojnë në literaturën historike, është dhënë edhe mendimi personal, si për origjinën e familjes tepelenase, të ardhurat e saj, të parët e familjes së Hysovet, arsyen që Aliu s'kishte pse ta fillonte karrierën si hajdut kecash, por si një bej që merrej me rekrutimin e forcave ushtarake, fenomen mjaft i përhapur për atë kohë, marrëdhëniet me Ahmet Kurt Pashën. Dokumentet e reja bëjnë të ditur se me forcat e tij të armatosura ai kishte hyrë në shërbim të qeveritarëve osmane, por ishte i pakënaqur, prandaj u detyrua të hedhë vështrimin tek Kapllan Pasha. Dokumentet e reja hedhin poshtë mendimet e letërsisë historike rreth disa vrasjeve si të vjehrrit, të Selim Pashës etj., të cilat i atribuohen Aliut. Për shërbimet ai emërohet qeveritar i Delvinës. Mjaft interesante dhe e dokumentuar është marrja e Janinës prej Ali Pashës, të cilën nuk e lëshoi ndonëse disa herë pushteti qendror, ia hoqi atë.

Dokumentet e reja osmane përforcojnë të dhënat e burimeve të tjera rreth marrëdhënieve të Aliut me familjen e Bushatllinjve, ndriçojnë më tej aspektet e marrëdhënieve me pushtetin qendror, duke u paraqitur një nëpunës i bindur.

Me mjaft sukses janë trajtuar ngjarjet që kanë qenë objekt i veprave letrare si kapja rob e Hankos, lufta me suliotët, masakrat e Hormovës, të Kardhiqit dhe të Valaresë, çështja Frosinë dhe mbytja e grave të akuzuara për imoralitet, “dashuria e vjehrrit me nusen, njohja me Vasiliqinë shqiptare etj. Ndërsa shumica e autorëve të deritanishëm ngrejne lart luftën e suliotëve, autori e shikon si një domosdoshmëri mbasi suliotët jo vetëm ishin bërë pengesë për shtrirjen e pushtetit në atë krahinë, por po kërcënonin edhe qytetin e Janinës. Krerët suliotë ishin kthyer në një kastë grabitqare që rronte “me marrjen nën mbrojtje” të qindra fshatrave kundrejt një haraçi dhe me grabitje të drejtpërdrejta.

Gjithashtu dokumentet e reja u japin fund mendimeve të autorëve rreth kohës së emërimit të Aliut si vali i Rumelisë (1802-1804). Arsyeja e emërimit ishte nevoja e pushtetit qendror për t’i bërë ballë lëvizjes së malësorëve e njohur si lëvizja e Kërxfhalinjve, ku ishin përfshirë mjaft krerë shqiptarë pak të njohur. Pushteti qendror, shkeli praktikën e emërimeve shtetërore, duke i lënë të gjitha detyrat e mëparshme, gjë që dëshmon për nevojën për Aliun. Ai me politikën e kulaçit e të kërbaçit arriti të shpërndajë turma malësorësh, duke i vendosur në tokat e mbetura bosh, kurse disa të tjerë u ekzekutuan. Nga rritja e frikës tek pushteti qendror, duke u justifikuar me ankesat e ajanëve të Rumelisë, të cilëve u kishte ardhur hakut, Aliu u pushua nga ajo detyrë.

Me mjaft të dhëna të reja trajtohen: problemi i premtimit të Bonapartit për t’i dhënë Korfuzin, akuzat nga letërsia historike se Aliu ishte organizatori i komplotit për rrëzimin e sulltan Selimit III, marrëdhëniet armiqësore të Aliut me shqiptarin tjetër Mustafa Pashë Bajraktari nga Goskova e Korçës, zgjerimi i pashallëkut të Janinës deri në vitin 1812.

Në punim del qartë se ngjarjet ndërkombëtare, veçanërisht Kongresi i Vjenës i prenë vrullin e zgjerimit të pashallëkut më tej. Prej kësaj periudhe Aliu synonte të merrte Pargën dhe u përpoq të mbronte ato që kishte arritur.

Gjatë tre krerëve (XXI-XXIII) trajtohet qëndresa e Aliut ndaj ndëshkimit të pushtetit qendror. Ndonëse Aliu ishte përgatitur për t’i rezistuar gjatë ushtrisë osmane, dokumentet e reja osmane i kanë dhënë

mundësi autorit të tregojë sesi u bë pluhur e hi kjo përgatitje e gjatë, nga tradhtia e bijve dhe nipave, e bashkëpunëtorëve më të ngushtë.

Duke dhënë versionet rreth ekzekutimit të Aliut në ishullin e liqenit të Janinës, autori përpiqet të rrëzojë versionin e Reis efendiut.

Mjaft interesante është pjesa e dytë që ka shtatë krerë dhe një mbyllje. Ajo nis me analizën e figurës komplekse të Aliut që nga shtati dhe pamja fizike, cilësitë morale, arsimi dhe kultura, marrëdhëniet me fenë, muzika deri në veshjet dhe armët e Aliut. Mjaft të argumentuara dalin pushtetet e Aliut në krye të pashallëkut, si sulltan i Janinës, pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor, roli i tij në jetën ekonomike, të ardhurat e Aliut, krijimi i një brez mbrojtjeje dhe të një ushtrie moderne për kohën, krijimi i shtetit si një regjim despotik, etniciteti i tij .

Në mbyllje jepet një vlerësim i përgjithshëm i veprës së Aliut dhe rëndësia e tij për shqiptarët, për shtetin osman, për ballkanasit dhe veçanërisht për grekët.

Në fund të recensës shpreh mendimin se, vepra pa mëdyshje mund të konsiderohet vepra e dytë shkencore në letërsinë historike shqiptare kushtuar jetës dhe veprës së Ali Pashë Tepelenës.

Prof. Dr. Marenglen VERLI

